



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

03.10.2022, Prishtinë

Thirrje për aplikim

Bazuar në Thirrjen publike për projekt-propozimet kulturore 2022 art dhe trashëgimi kulturore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Nenin 8, paragrafin 3.2 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojme organizatat jo qeveritare, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

- përfaqësues nga OJQ-të

Të drejtë aplikimi kanë të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Përfaqësuesi nga OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

Përfaqësuesit e lartpërmendur do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve për projekt-propozimet kulturore 2022 art dhe trashëgimi kulturore të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës: 22.08.2022.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: tylaj.shilek@rks-gov.net deri me datën 06.10.2022, dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**

MKRS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe do të përzgjedhë një kandidatë, që do të jetë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike të datës 22.08.2022 të publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.